

RELACION
“PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 75/2014 “PËR SHËRBIMIN
PRIVAT
TË SIGURISË FIZIKE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Shërbimi privat i sigurisë fizike në vendin tonë është një shërbim që ofrohet që nga viti 1993.

Ky shërbim ka si objektiv të veprimtarisë së tij sigurimin fizik të objekteve shtetërore e private, të personave, të veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare dhe politike, sigurimin e shoqërimit e vlerave monetare, materiale e sendeve të çmuara gjatë transportit, si dhe trajnimin dhe kualifikimin e personelit të këtij shërbimi nëpërmjet Qëndrave të Trajnimit Privat.

Menaxhimi i këtij shërbimi bëhet kryesisht nga ish- punonjës policie të niveleve të ndryshme dhe ish- ushtarakë të forcave të armatosura që kanë mbaruar arsimin e lartë policor ose ushtarak, të cilët janë drejtuesit më të lartë teknik për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e tij.

Nga studimi i praktikës së deritanishme, arrijmë në konkluzion se duhet të rregullohen disa aktivitete në shërbimin privat të sigurisë fizike, duke përmbushur kështu edhe disa objektiva si:

1. Megjithëse ligji 75/2014 “Për SHPSF”, në këto vite luajti një rol të rëndësishëm në konfigurimin e shërbimit privat të sigurisë fizike, janë evidentuar problematika për të cilat është domosdoshmëri ndërhyrja apo rregullimi në ligj, me qëllim forcimin e kritereve që nga marrja e licencës, trajnimi i punonjësve dhe ushtrimi i veprimtarisë së këtij shërbimi.
2. Mbas ndryshimeve të ligjit, është e nevojshme të bëhen ndryshime edhe në aktet nënligjore si udhëzimet e Ministrit të Brendshëm, procedurat standarde etj., me qëllim që ligji të marrë trajtë dhe të zbatohet në mënyrë të plotë.
3. Forcimin e rregullave të rekrutimit në subjektet e shërbimit privat të sigurisë fizike, me qëllim parandalimin dhe përjashtimin e personave të papërshtatshëm.
4. Rritjen e efikasitetit të kontroleve të strukturave të Policisë së Shtetit ndaj këtij shërbimi, duke vendosur një rregjim të rreptë kontrolli dhe monitorimi, sepse ende nga subjektet e SHPSF ka shkelje të ligjit, mos plotësim të detyrimeve ndaj punonjësve të punësuar etj.
5. Forcimin e regjimit të kontrollit të armatimit në zotërim të këtyre subjekteve, duke bërë reduktimin e tyre dhe eliminimin e armatimit ushtarak të sulmit nga arsenalit i tyre.

6. Parashikimin e masave shtërnguese në drejtim të automjeteve të blinduara që këtij shërbimi i janë dhënë në dispozicion, me qëllim përdorimin e tyre vetëm për qëllimin për të cilat ato janë miratuar.

Gjithashtu, miratimi i VKM nr. 301, datë 5.4.2017 “Për ndryshime në VKM nr.538, datë 25.6.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga dhe nëpërmjet QKB...” të ndryshuar në të cilën është shtuar nënkategoria 1.3C e licencës “ Qendër e Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF”, bën të domosdoshëm rregullimet e këtij ligji duke përcaktuar kriteret dhe detyrimet e subjekteve të licencuara për nënkategorinë 1.3C.

Qëllimi final i këtij ndryshimi, është që mbi bazën e prioritetëve të Ministrisë së Brendshme dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të përvojës së arritur në fushën e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe të evidentimit të problematikave të deritanishme, nëpërmjet propozimeve për ndryshime në Ligjin 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, si dhe në aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e këtij shërbimi, të ngrihet në një shkallë më të lartë efektiviteti i këtij shërbimi.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për katërmujorin e dytë për Ministrinë e Brendshme.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Veprimtaria e SHPSF rregullohet me ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, i cili ka shfuqizuar ligjin e mëparshëm nr. 8770, datë 19.04.2001 “Për shërbimin e ruajtjes e sigurisë fizike”.

Ligji i ri u hartua me qëllim reflektimin e zhvillimeve në fushat e tregut dhe atë ligjor, por edhe për të ofruar një kuadër më të mirë rregullator për veprimtarinë e shërbimit privat të sigurisë fizike në vend, shërbim që ka qenë në rritje vazhdimisht, por që kjo rritje nuk është shoqëruar me rritjen e cilësisë në ofrimin e shërbimit.

Me qëllim krijimin e kushteve për një treg më të mirë privat të sigurisë, ligji hoqi një sërë pengesash ligjore që dëmtonin konkurrencën, pengonin rritjen e investimeve të SHPSF-ve si dhe e hapi tregun shqiptar për operatorët ndërkombëtarë.

Përveç kësaj, ai synoi përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke u bërë të mundur SHPSF-ve të rekrutojnë dhe të mbajnë një fuqi punëtore më cilësore dhe më të motivuar, duke përcaktuar si pagë minimale për punonjësit privat të sigurisë, atë prej 50% më të lartë se paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi.

Për të përmbushur objektivat e përcaktuara, ligji 75/2014 “Për SHPSF”-të vendosi dispozita të cilat synuan në:

- Përmirësimin e kriterëve dhe standardeve në lidhje me aftësitë profesionale që duhet të ketë aplikanti (shoqëritë, administratorët, drejtuesit teknikë, punonjësit e shërbimit) për të marrë licencë dhe ushtrimin e aktivitetit.
- Përmirësimin e procedurave të verifikimit dhe kontrollit të personelit të SHPSF-ve, përfshirë aksesin tek të dhënat fizike e elektronike që kanë të gjitha institucionet shtetërore.
- Licencimin e qendrave private të trajnimit për personelin e sigurisë private.
- Detyrimin për t’u paguar punonjësve të shërbimit një pagë minimale 50% më të lartë se paga bazë minimale e punonjësve në shkallë vendi.
- Ndalimin e dhënies me kontratë të këtij shërbimi nga një kompani tek tjetra me synim përmirësimin e kontrollit e përgjegjësisë për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata.
- Përmirësimin e procedurave të mbajtjes, përdorimit të armëve e forcës në veprimtarinë e tyre.
- Sigurimin e kriterëve dhe kushteve për përmbushjen e detyrueshme të qendrës së kontrollit.
- Përmirësimin e kriterëve, kushteve dhe specifikimeve teknike për mbajtjen, licencimin dhe përdorimin e mjeteve të blinduara.
- Njohjen e të drejtës shtetasve të huaj për të krijuar subjekt të SHPSF dhe për t’u punësuar në sektorin e sigurisë private në Shqipëri.
- Ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, për trajtimin e ankesave të subjekteve ndaj masave administrative.

Shoqëritë private të sigurisë fizike ushtrojnë aktivitetin e tyre të licencuara nga Qendra Kombëtare e Biznesit sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

Aktualisht sipas të dhënave të 3-të mujorit të parë të vitit 2022, në Shqipëri ushtrojnë aktivitetin **189** subjekte të shërbimit privat të sigurisë fizike për tre kategoritë, me **8737** punonjës shërbimi, kanë në ruajtje **2665** objekte, **787** automjete, nga të cilat 200 automjete të blinduara për transportimin e vlerave monetare, shërbimi ka në dispozicion **2055** armë zjarri etj.

Problematikat e identifikuara në veprimtarinë e SHPSF-ve, nga kontrollet e ushtruara ndaj këtij shërbimi, kanë evidentuar mos zbatimin e plotë të ligjit. Konkretisht:

- Mos zbatimi i dispozitës për pagën minimale të punonjësit të shërbimit, e cila është evidentuar si një nga problemet kryesore nga Policia e Shtetit gjatë kontrollit dhe inspektimeve të kryer për subjektet e SHPSF-së.
- Mos zbatimi i Kodit të Punës, pasi punonjësit e shërbimit duhet të punojnë 174 orë në muaj.
- Nuk janë ngritur dhe funksionuar qendrat e kontrollit të shërbimeve nga të gjitha subjektet (neni 22, në çdo njësi administrative, apo në nivel qarku).
- Menaxhimi jo i mirë i shërbimeve nga drejtuesit teknik të SHPSF-ve, bashkërendimi i punës midis DVP-ve dhe subjekteve të SHPSF dhe kontrolli ndaj këtyre të fundit.
- Bashkëpunim më të mirë me strukturat e tjera ligj zbatuese si me Drejtorinë e Tatimeve, Zyrën e Inspektoratit të Punës etj.
- Kontratat e nënshkruara midis subjekteve të SHPSF dhe institucioneve publike/jopublike, jo të gjitha janë të specifikuara në zëra lidhur me numrin e vendrojave për sigurimin e objekteve, transportimin dhe shoqërimin e vlerave monetare, çmimin e kontraktuar për një punonjës shërbimi, shërbim për verifikimin e sinjalit të alarmit me grup të gatshëm, të vëzhgimit (kamerave) dhe për mirëmbajtje të sistemeve, shërbimin GPS / GPRS për automjetet etj.
- Subjektet e SHPSF zbatojnë çmime të ndryshme për punonjës, në varësi me kërkesën e tregut dhe procedurat e prokurimit që kanë kryer me institucionet publike.
- Agjencia e Prokurimit Publik ka konstatuar se prokurimi i ruajtjes me punonjës shërbimi të SHPSF, ka sjellë mjaft problematika ndër vite, të cilat janë fokusuar në drejtim të përlllogaritjes së fondit limit, ofertimit në këto procedura dhe procesit të ankimimit.
- Nga disa subjekte të SHPSF, nuk respektohet detyrimi ligjor për të planifikuar dhe realizuar shërbim referuar koeficientit 1.66 punonjës policie për vendroje.
- Punonjësit e shërbimit jo në të gjitha rastet i gëzojnë të drejtat e përcaktuara në nenet 78, 81, 85 e 86 të Kodit të Punës dhe nga ligji 75/2014, të drejta të cilat kanë të bëjnë me të drejtën e pagesës për punën e bërë natën, orët e punës në turnin e dytë etj.
- Punonjësve të shërbimit megjithëse punojnë për 30 apo 31 ditë në muaj (përjashtoj muajin shkurt), në listë pagesat e dorëzuara për efekte të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore apo shëndetësore, u shënohen vetëm 22 ditë pune.
- Subjektet e SHPSF-ve, kanë bërë pagesa të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit, duke marrë për bazë pagën minimale bruto dhe jo pagën që punonjësi duhet të marrë për punën reale që ai bën gjatë një muaji, për rrjedhojë vlera e këtyre është e vogël.

Për shkeljet e evidentuara gjatë kontrolleve, si dhe shkelje të tjera, janë mbajtur procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjes administrative ndaj subjekteve të SHPSF-së,

cilat janë shqyrtuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim në DVP dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke marrë masa administrative, deri në propozim të heqjes së licencës apo certifikatës.

Pas miratimit të ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, janë nxjerrë aktet nënligjore për implementimin dhe zbatimin e tij në praktikë, ku u përcaktua dokumentacioni dhe procedurat për pranimin, verifikimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit për certifikimin e drejtuesit teknik dhe titullarit të subjektit SHPSF-së dhe QTP-së.

Në këtë kuadër u përgatit dhe u miratua Udhëzimi i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 157, datë 01.04.2015 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”.

Por gjatë zbatimit në praktikë të këtij udhëzimi, u konstatuan disa probleme, si disa vjedhje me armë (grabitjeve) të eskortave të SHPSF-ve që shoqëronin vlerat monetare, mos parashikimin e licencimit të dhe të funksionimit të Qendrave të Trajnimit Privat, të punonjësit e SHPSF-së, sipas përcaktimit në nenin 29 të ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”; mungesa e kapaciteteve nga ana e Akademisë së Sigurisë për përballimin në vijimësi të trajnimeve të aftësimit teorik dhe praktik të punonjësve të SHPSF, mungesa e përcaktimit në një VKM të licencës të nënkategorisë 1.3.C “Qendra të Trajnimit Privat të Punonjësve të Shërbimit të SHPSF-së” etj.

Në vlerësim të problematikëve të mësipërme dhe të bashkëpunimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me Qendrën Kombëtare të Biznesit, u hartua dhe u miratua VKM nr. 301, datë 05.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 538, datë 26.05.2009, për licencat dhe lejet që trajtohen nga / apo / nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkët”, i ndryshuar.

Miratimi i këtij akti, bëri të domosdoshme hartimin e Udhëzimit të ri “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendra të Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së” i cili u miratua me urdhër të MPB nr. 308, datë 22.05.2017 dhe hyri në fuqi me botimin në fletoren zyrtare nr. 128, datë 07.06.2017.

Për hartimin e udhëzimit është bashkëpunuar me përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave, Komitetin e Sigurisë së Bankave të Nivelit të Dytë dhe Shoqatat e Shërbimeve Private të Sigurisë Fizike (SHPSF). Mendimet dhe sugjerimet e tyre u morrën në konsideratë dhe e reflektuan në këtë udhëzim.

Standardet e parashikuar në udhëzim do të sillnin një impakt pozitiv në aktivitetin e SHPSF-ve të nënkategorisë 1.3.B, duke reduktuar numrin e tyre, i cili do të ndikonte në rritjen e standardeve dhe cilësinë e këtyre shoqërive, si dhe do të shmangte konkurrencën e pa ndershme gjatë procesit të tenderimit të këtij shërbimi *(ndër të tjera në udhëzim, u*

përcaktuan rregulla dhe kriteret të qarta për transportimin e vlerave monetare, nga subjektet e pajisur me licence të nënkategorisë 1.3.B).

Gjithashtu, një impakt pozitiv i Udhëzimit nr. 308, evidentohet edhe në drejtim të ngritjes dhe funksionimit të Qendrave të Trajnimit Privat të Punonjësve të SHPSF-së, ku fillimisht u licencuan 5 subjekte të nënkategorisë 1.3.C.

Akademia e Sigurisë, në funksion të trajnimit të punonjësve të SHPSF-ve, hartoi dhe miratoi programet e trajnimit që u zhvilluan si në Akademinë e Sigurisë ashtu edhe në QTP të punonjësve të SHPSF-së dhe së bashku me QTP filluan trajnimet e punonjësve të shërbimit.

Me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 899, datë 14.09.2017 “Për anulimin e udhëzimit nr. 308 datë 22.05.2017, të Ministrit të Punëve të Brendshme “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrave të Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-së”, u anulua udhëzimi nr. 308 datë 22.05.2017. Në vijim të kësaj detyre, DPPSH ngriti grupin e punës me urdhër nr. 1037, datë 17.10.2017 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit të punës për hartimin e Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-së”.

Udhëzimi i ri i Ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, konsideroi dhe reflektoi disa nga sugjerimet e grupeve të interesit (Departamenti i Sigurisë i Bankës së Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave, Komiteti i Sigurisë Fizike të Bankave të Nivelit të dytë, Unioni i SHPSF-së “Security Albania”, subjekte të SHPSF-ve dhe QTP), si dhe të Akademisë së Sigurisë.

Nga strukturat vendore dhe qendrore të Policisë së Shtetit janë ushtruar kontrolle të vazhdueshme për përmirësimin e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike dhe eliminimin e të metave dhe mangësive të konstatuara. Vetëm për 3 mujorin e vitit 2022 janë konstatuar 8 ngjarje të ndryshme në objektet që siguron shërbimi privat i sigurisë fizike.

Nga kontrollet e ushtruara nga strukturat vendore dhe qendrore të Policisë së Shtetit për këtë periudhë janë vendosur 21 masa administrative ndaj subjekteve apo punonjësve të shërbimit privat të sigurisë fizike, janë hequr 2 certifikata titullar subjekti/drejtnes teknik dhe 7 licenca të SHPSF-ve.

Produkti përfundimtar që pritet të arrihet me miratimin e këtij projektligji është rregullimi i veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike në disa drejtime dhe përmirësimi i tyre, për të cilat në ligjin aktual janë konstatuar mangësitë e mësipërme.

Miratimi i këtij projektligji do të sjellë rritjen e efektivitetit të punës së shërbimit privat të sigurisë fizike, për sigurimin e objekteve të rëndësishme, të vlerave monetare dhe për trajnimin e personelit të këtij shërbimi, vendosjen e një raporti më të drejtë të ushtrimit të kontrollit të strukturave të Policisë së Shtetit ndaj këtij shërbimi, me qëllimin final

kontributin e tij për parandalim, zbulimin dhe kapjen e autorëve të veprave penale, atje ku ky shërbim është kontraktuar nga subjektet e ndryshme dhe kryen funksionet e tij.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në harmoni me legjislacionin vendas.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk ka përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Disa nga çështjet kryesore që rregullon projektligji i paraqitur në mënyrë të përmbledhur janë:

Neni 1 përcakton se:

1. Kudo në ligj togfjalëshi “Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL)” dhe togfjalëshi “Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR)”, zëvendësohen me togfjalëshin “Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)”.
2. Në nenet 25, 26, 30, 31, 39, 40, 41, 43 pas emërimit SHPSF -së, shtohet emërtimi: “dhe QTP-së”.

Neni 2 përcakton se:

Në nenin 2 pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:
“c. Trajnimi i punonjësve të shërbimit privat të sigurisë fizike”.

Neni 3 përcakton se:

Në nenin 3 bëhen shtesa dhe ndryshime si më poshtë

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:
“4. “DVP” është Drejtoria Vendore e Policisë
2. Pas pikës 16 shtohet pika 16/1 me këtë përmbajtje:
“16/1. “Përgjegjësi i shërbimit” është punonjësi i shërbimit i caktuar në detyrë nga titullari i subjektit pas kryerjes së trajnimit të specializuar dhe ka për detyrë planifikimin, organizimin dhe kontrollin e shërbimit për një objekt, ose grup objektesh”
3. Pika 18 ndryshohet si më poshtë:

“18. Qendra e Menaxhimit të Shërbimeve (QMSH)”, është ambienti i kompletuar me personel të specializuar, mjete dhe pajisje elektronike që shërben për menaxhimin dhe monitorimin e veprimtarisë të sigurisë fizike”

4. Pika 19 shfuqizohet.

5. Pika 20 ndryshohet si më poshtë:

“20. “QKB” është Qendra Kombëtare e Biznesit.”

6. Pika 21 shfuqizohet.

7. Pas pikës 23 shtohet pika 23/1 me këtë përmbajtje:

“23/1. “QTP” është Qendra e Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-së është subjekti i licencuar që ofron trajnime të punonjësve të shërbimit privat të sigurisë fizike”.

8. Pas pikës 26 shtohet pika 26/1 me këtë përmbajtje:

“26/1. Trajneri është specialisti për trajnimin e punonjësve të SHPSF-së, i kualifikuar dhe certifikuar nga institucioni arsimor përgjegjës për arsimin, formimin dhe trajnimin e punonjësve të Policisë së Shtetit”

9. Pas pikës 27 shtohet pika 28 me këtë përmbajtje:

“28. Vlerësimi i riskut është procesi i mbledhjes dhe analizimit të informacioneve dhe të dhënave për identifikimin e rreziqeve të mundshme për jetën dhe shëndetin e personave të cilët kërkojnë mbrojtje fizike të afërt, trupprojë”.

10. Pas pikës 28 shtohet pika 29 me këtë përmbajtje:

“29. “Zyra e menaxhimit të shërbimit” është ambienti i kompletuar me pajisjet e nevojshme që shërben për mbajtjen, administrimin e dokumentacionit, armatimit e pajisjeve të tjera të shërbimit dhe për instruktimin e punonjësve të shërbimit”.

Neni 4 përcakton se:

Në nenin 5 bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 1 pas emërimit SHPSF -së, shtohet “ dhe QTP –së”.

2. Pika 5 ndryshon si më poshtë:

“5. Certifikata për titullarin e subjektit, për drejtuesin teknik dhe punonjësin e shërbimit, është e vlefshme për 5 vjet me të drejtë ripërtëritje”.

3. Pika 6 ndryshon si më poshtë:

“6. Ngritja, funksionimi, kompetencat, përbërja dhe procedurat e komisionit për certifikim/licencim rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike”

4. Pika 7 shfuqizohet.

Neni 5 përcakton se:

Në nenin 6 bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 1, pas emërimit SHPSF -ve, shtohet emërimi QTP -ve.

2. Pika 2 ndryshon si më poshtë:

“2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit publikon në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për miratimin, refuzimin dhe shfuqizimin e licencës, bazuar në propozimin e KSHKCL-së”.

Neni 6 përcakton se:

Në nenin 7 bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

1. Paragrafi parë ndryshon si më poshtë:

“Licencat sipas këtij ligji, ndahen në tre nënkategori”

2. Pas pikës “b”, shtohet pika “c” me këtë përmbajtje:

“c. Nënkategoria 1.3.C, “Qendra të Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF”, e cila ushtrohet në të gjithë territorin e vendit”.

Neni 7 përcakton se:

Neni 8 ndryshon si më poshtë:

“Çdo subjekt ka të drejtë të përfitojë njëkohësisht licencën e nënkategorisë 1.3.A, 1.3.B dhe 1.3.C me kusht që për secilën nënkategori të ketë drejtues teknik më vete”.

Neni 8 përcakton se:

Në nenin 9 bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshon si më poshtë:

“1.Certifikatat për titullarin dhe drejtuesin teknik të SHPSF-së dhe QTP-së jepen sipas nënkategorive të licencës 1.3A, 1.3B dhe 1.3C”.

2. Pika 2 ndryshon si më poshtë:

“2. Certifikatat për punonjësin e shërbimit të SHPSF-së, jepen sipas nënkategorive të licencës 1.3A, 1.3B”.

Neni 9 përcakton se:

Neni 10, shkronja c ndryshohet si më poshtë:

“c. Të mos jetë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje”.

Neni 10 përcakton se:

Në nenin 11 bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë

1. Pika 1, shkronja “a”, shfuqizohet.

2. Pika 1, shkronjat “ç”, “dh” dhe “e” ndryshohen si më poshtë;

“ç. Të jetë me arsim të lartë dhe të ketë mbi 3 vjet përvojë pune në funksione të nivelit menaxhues në institucionet e sigurisë publike ose kombëtare”.

“dh. Të mos jetë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje”.

“e. Të mos jetë larguar/liruar/përfjashtuar nga institucionet e sigurisë publike e kombëtare për shkaqe disiplinore në 3 vitet e fundit nga data e aplikimit”

3. Pika 2, shfuqizohet

Neni 11 përcakton se:

Në nenin 12 bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 1 shkronja “d” ndryshon si më poshtë:

“d. Të ketë përfunduar arsimin bazë”.

2. Pika 1, shkronja “ç” shfuqizohet.

3. Pika 1 shkronja “e” ndryshon si më poshtë:

“e) Të mos jetë i dënues me vendim gjykatë të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje”.

4. Pika 1 shkronja “ë” ndryshon me këtë përmbajtje:

“ë) Të mos jetë larguar/liruar/përfunduar nga institucionet e sigurisë publike e kombëtare për shkaqe disiplinore në 3 vitet e fundit nga data e aplikimit”.

Neni 12 përcakton se:

Në nenin 13 bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

1. Paragrafi i parë numërohet pika 1.

2. Pas pikës 1, shtohet pika 2 me përmbajtjen si më poshtë:

“2. Shtetasit e huaj gëzojnë të drejtën të certifikohen si drejtues teknik dhe punonjës shërbimi të subjektit nëse plotësojnë, përveç kriterëve të veçanta të përcaktuara në këtë ligj, edhe kriteret e mëposhtme:

a) të jetë i pajisur me leje pune nga autoritetet përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë;

b) të jetë i pajisur me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë;

c) të marrë miratimin paraprak nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

ç) të përmbushë kriterin e besueshmërisë, sipas kuptimit të këtij ligji.”

Neni 13 përcakton se:

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

1. Për pajisjen me licencë të nënkategorive 1.3.A, 1.3.B dhe 1.3.C, subjekti duhet të plotësojë këto kriterë:

a) Të jetë i regjistruar në QKB si Sh.A ose Sh.P.K dhe të ketë përcaktuar më parë drejtuesin teknik për nënkategorinë që do të licencohet.

b) Titullari i subjektit të jetë i pajisur me certifikatën e nënkategorisë për të cilën do të licencohet.

c) Drejtuesi teknik të jetë i pajisur me certifikatën e nënkategorisë së subjektit ku do të punësohet, si dhe të jetë punësuar me kohë të plotë pune në subjektin e SHPSF/QTP.

ç) Të ketë lidhur kontratë pune ndërmjet titullarit dhe drejtuesit teknik”.

2. Për nevoja të veçanta pune ose në rastet e ushtrimit të aktivitetit të SHPSF me një numër të konsiderueshëm punonjësish, subjekti mund të punësojë më shumë se një drejtues teknik për secilën nënkategori licence.

Kriteret e hollësishme dhe standardet për përmbushjen e kriterëve për ushtrimin e aktivitetit 1.3.A, 1.3B, 1.3 C si dhe për punësimin e më shumë se një drejtuesi teknik, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”.

Neni 14 përcakton se:

Neni 16, pika 5 ndryshon si më poshtë:

“5. Ankimi ndaj Vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për refuzimin dhe shfuqizimi e certifikimit dhe licencës pas shqyrtimit të ankimit, bëhet në Gjykatën Administrative.”

Neni 15 përcakton se:

Në nenin 17, pika 1, 2, 3 dhe 5 ndryshojnë si më poshtë:

“1. Ripërtëritja e afatit të certifikatës për titullarin e subjektit, drejtuesin teknik dhe punonjësin e shërbimit bëhet me mbarimin e afatit 5 vjeçar nga koha e dhënies së saj”.

“2. Aplikimi për ripërtëritjen e certifikatës bëhet 90 ditë kalendarike para datës së përfundimit të afatit”.

“3. Ripërtëritja e certifikatës bëhet pasi rishqyrtohen kriteret e certifikimit sipas kërkesave të këtij ligji”.

“5. Mosripërtëritja e certifikatës nuk e heq të drejtën e aplikimit për pajisje me certifikatë të re”.

Neni 16 përcakton se:

Në nenin 18, bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 2, ndryshohet si më poshtë:

“2. Nënkontraktimi i kësaj veprimtarie lejohet vetëm duke respektuar të njejtat kushte dhe kriteret të pranuar në kontratën bazë të SHPSF-së, pas miratimit paraprak të Policisë së Shtetit.”

2. Pas pikës 2, shtohet pika 3:

“3. Subjektet e SHPSF-së që ushtrojnë veprimtari të ruajtjes së personave fizikë/juridikë, përpara lidhjes së kontratës së shërbimit, paraqesin kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë Vendore të Policisë për kryerjen e vlerësimit të riskut të subjektit që kërkon ruajtje të afërt. Ngritja, funksionimi dhe përbërja e komisionit të vlerësimit të riskut, si dhe formati i vlerësimit të riskut, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”.

Neni 17 përcakton se:

Në neni 19 pas emërimit “SHPSF-ve” shtohet emërimit “QTP-ve”.

Neni 18 përcakton se:

Në nenin 20 bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 1, pas emërimit “SHPSF-se”, shtohet emërimi “QTP-se”

2. Në shkronjat “a”, “b” dhe “dh”, të pikës 1, bëhen ndryshimet si më poshtë:

“a) kryejnë monitorimin nëpërmjet dokumentacionit, për aktivitetin e shoqërive të sigurisë

fizike dhe qendrave të trajnimit të punonjësve të SHPSF-së”;

“b) kryejnë inspektive në terren për veprimtarinë e shoqërive të sigurisë fizike dhe qendrave të trajnimit të punonjësve të SHPSF-së”.

“dh) bëjnë identifikimin e shkeljeve të rregullave të shërbimit, mbajnë procesverbal konstatimi, ndjekin procedurat për marrjen e masave administrative”.

Neni 19 përcakton se:

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 22

Menaxhimi i Shërbimit të SHPSF-së

1. Për menaxhimin e shërbimit të SHPSF-së subjekti i licencuar duhet të plotësojë këto kushte:

a) Të ngrejë strukturën e QMSH për nënkategorinë 1.3A dhe 1.3B e cila miratohet para fillimit të aktivitetit nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit.

b) Të ngrejë zyrën e menaxhimit të shërbimit në qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF-së e cila miratohet para fillimit të aktivitetit nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit.

c) Procedurat e miratimit, funksionimit, standardet e Qendrës së Menaxhimit të Shërbimit dhe Zyrës së Menaxhimit të Shërbimit të SHPSF-së, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike.

Neni 20 përcakton se:

Në nenin 24 bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) të marrë masa për zhvillimin e aktivitetit për të cilin është licencuar në përputhje me kushtet e kriteret e vendosura në këtë ligj”.

2. Shkronja “c” dhe “f” shfuqizohen.

3. Shkronja “k” ndryshon si më poshtë:

“k) Të njoftojë menjëherë Policinë e Shtetit për çdo ngjarje të ndodhur gjatë kryerjes së veprimtarisë.”

4. Shkronja “ll” ndryshon si më poshtë:

“ll. Titullari i një subjektit të SHPSF nuk mund të jetë titullar i më shumë se një subjekti të SHPSF-së”.

5. Shkronja “m” ndryshon si më poshtë:

“m) Të njoftojë menjëherë strukturën e policisë kur bëhet largimi i drejtuesit teknik si dhe të aplikojë për zëvendësimin e tij brenda 15 ditëve (kompetencat në mungesë i kalojnë përkohësisht përgjegjësit të shërbimit me urdhër të titullarit të subjektit deri në miratimin e drejtuesit teknik)”.

6. Pas shkronjës “m” shtohen shkronjat “n”, “o”, “p”, “q”, “r”, me këtë përmbajtje:

“n) Zbaton detyrimet kontraktuale në lidhje me numrin e vendrojave, numrin e punonjësve për çdo vendroje, grupet verifikuese, si dhe për pajisjet sinjalizuese alarmi, kamera sigurie ose qen shërbimi”.

“o) Njofton Policinë e Shtetit dhe QKB, brenda 10 ditëve për çregjistrimin e ktivitetit si dhe për çdo ndryshim faktik të të dhënave të veprimtarisë së tij.

“p) Njofton Policinë e Shtetit për ndryshimet faktike të cilat kanë të bëjnë me kriteret e licencimit”.

“q) Njofton menjëherë Policinë e Shtetit për lidhjen e kontratave të reja, si dhe për çdo ndryshim që pëson kontrata e lidhur që ka të bëjë me aftësinë e sigurisë fizike të objekti dhe brenda 30 ditëve, dorëzon kopje të saj në strukturat vendore të Policisë.

Subjekti i SHPSF-së në çdo rast ruan të drejtën për të mos bërë publik çmimin e kontratës, përjashtimisht kur kërkohet për qëllime statistikore nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit.

“r) Ruan dokumentacionin e aktivitetit të subjektit në arkiva sipas rregullave të përcaktuara në ligjin përkatës”.

Neni 21 përcakton se:

Pas neni 24 shtohet neni 24/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 24/1

Titullari i Qendrës së Trajnimit Privat

1. Titullari i Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-së, kryen këto detyra:

a)merr masa për zhvillimin e aktivitetit për të cilin është licencuar në përputhje me kushtet e kriteret e vendosura në këtë ligj.

b)trajnon dhe pajis me certifikatë punonjësit e shërbimit që kryejnë kursin e plotë të trajnimit dhe që shpallen fitues në testimin përfundimtar sipas programit të miratuar.

c)lidh kontrata individuale pune me trajnerët e certifikuar për trajnime në fushën e SHPSF -ve.

ç) aplikon për ripërtëritjen e certifikatës jo më vonë se 90 ditë para përfundimit të afatit.

d) informon çdo 3 muaj strukturat e Policisë së Shtetit për veprimtarinë e QTP-së.

dh) ruan dokumentacionin e aktivitetit të subjektit në arkiva sipas rregullave të përcaktuara në ligjin përkatës.

e) nuk punëson në veprimtarinë e QTP-së trajnerë të pa certifikuar.

ë) njofton menjëherë strukturën e policisë kur bëhet largimi i drejtuesit teknik dhe për cdo trajner, si dhe brenda 15 ditëve duhet të aplikojë për zëvendësimin e tyre.

f) njofton Policinë e Shtetit dhe QKB, brenda 10 ditëve për mbyllje të aktivitetit.

g) njofton Policinë e Shtetit për ndryshimet që ka bërë në QKB të cilat kanë të bëjnë me kriteret e licencimit.

gj) përdorë aktivitetin e qendrës vetëm për qëllimin për të cilin është licencuar.

h) titullari i një subjektit të QTP nuk mund të jetë titullar i më shumë se një subjekti të QTP-së”.

Neni 22 përcakton se:

Në nenin 26 bëhen ndryshime dhe shtesa si më poshtë vijon:

1. Në paragrafin e parë, pas nënkategorisë 1.3.A, 1.3.B, shtohet nënkategoria “1.3.C”.

2. Shkronja “b” ndryshon si më poshtë:

“b. harton rregullat e funksionimit të veprimtarisë sipas nënkategorive të licencave të përfituara.

3. Shkronja “d” ndryshon si më poshtë:

“d. është përgjegjës për informimin në kohë të strukturave të Policisë së Shtetit për çdo ngjarje të ndodhur, si dhe siguron bashkëpunimin e vazhdueshëm për probleme që lidhen me sigurinë e objektit në ruajtje, dhe për situata emergjente planifikon plane të veçanta.”

4. Pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “dh/1” me këtë përmbajtje:

“dh/1) Harton planin e masave për aktivitetet sportive dhe aktivitete të tjera të cilin e dërgon për vlerësim paraprak në Komisaratin e Policisë në territorin e të cilit zhvillohet aktiviteti, si dhe është përgjegjës për marrjen e masave të sigurisë në mjediset përkatëse”.

5. Shkronja “f” ndryshon si më poshtë:

“f. Zbaton detyrimet ligjore për planifikimin e trajnimeve, njoftimin e punonjësve dhe mundësimin e pjesëmarrjes së tyre në trajnim”.

Neni 23 përcakton se:

Pas nenit 26, shtohet neni 26/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 26/1

Përgjegjësi i shërbimit

1. Përgjegjësi i shërbimit është punonjësi i shërbimit i caktuar në detyrë nga titullari i subjektit të SHPSF-së dhe është në varësi të drejtpërdrejtë të drejtuesit teknik, i cili merret me planifikimin, organizimin dhe kontrollin e shërbimit, për një objekt, ose disa objekte të caktuara.

2. Përgjegjësi i shërbimit ka këto detyra:

a) Është përgjegjës për planifikimin, organizimin dhe kontrollin e shërbimit në një objekt, ose disa objekte të caktuara.

b) Planëzon shërbimet për ruajtjen e objektit, personit fizik, apo shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje.

c) Merr masa dhe parandalon planëzimin në shërbim të punonjësve të shërbimit pa uniformë, armatim dhe pajisje shërbimi.

ç) Të mbajë sipas rregullores armatimin personal, uniformën e shërbimit, simbolet e SHPSF-së, mjetet speciale dhe mjetet e shërbimit dhe t’i përdorë ato vetëm gjatë kryerjes së detyrës.

- d) Të përdor armën sipas legjislacionit në fuqi.
 - dh) Të vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit, sa herë që kërkohet, për parandalimin e veprave penale dhe zbulimin e ngjarjeve të ndodhura në objektet në ruajtje apo që kanë lidhje me detyrën.
 - e) Ka përgjegjësi të konstatojë të metat dhe dobësitë e punonjësve të shërbimit, duke ia bërë të njohura titullarit, drejtuesit teknik dhe strukturave të policisë vendore.
 - ë) Merr masa për ruajtjen e vendit të ngjarjes, për rastet kur vepra penale ka ndodhur në territorin e objektit në ruajtje si dhe njofton Policinë e Shtetit, duke bashkëpunuar me strukturat e saj.
 - f) Të komunikojë me transparence, etikë dhe konform kërkesave të akteve ligjore me qytetarët, eprorët dhe me autoritetet ligjzbatuese.
 - g) Të mos përdorë mjetet e transportit të caktura për shërbim për interesa personale, për vete dhe për të tretët.
 - gj) Të ruajë dhe mirëmbajë mjetet e ndërlidhjes, të ndriçimit, si dhe pajisjet e tjera të dhëna për përmbushjen e detyrës.
 - h) Të shlyejë detyrimet financiare që vijnë nga masat administrative.
 - i) Të ruajë cilësitë morale, kodin etik për komunikim dhe sjellje qytetare, si dhe të mos përdorë gjatë shërbimit pije alkoolike, drogë e lëndë narkotike.
3. Kriteret, standardet dhe procedurat për përzgjedhjen e përgjegjësit të shërbimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike”.

Neni 24 përcakton se:

Në nenin 27, paragrafi i parë ndryshon si më poshtë vijon:

“Punonjësi i shërbimit privat të sigurisë fizike është punonjës i certifikuar në fushën e shërbimeve të sigurisë fizike dhe ka këto përgjegjësi”.

Neni 25 përcakton se:

Në nenin 28, pika 1 ndryshon si më poshtë vijon:

“1. Verifikimi i besueshmërisë për personat që aplikojnë për titullar subjekti, drejtues teknik, punonjës shërbimi të SHPSF -së dhe QTP-së, kryhet nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit në raport me të dhënat e regjistrave fizikë e elektronikë në administrim të Policisë së Shtetit dhe në regjistrat fizikë e elektronikë tek të cilat Policia e Shtetit ka akses.

Neni 26 përcakton se:

Në nenin 29 bëhen shtesa ndryshime më poshtë vijon:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 si vijon:

“1/1. Trajnimet e punonjësve të SHPSF-së në Qendrën e Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-së, kryhen nga trajneri i certifikuar nga institucioni arsimor policor sipas programit të miratuar të trajnimit. Trajneri i QTP duhet të jetë me arsim të lartë dhe të ketë mbi 5 vjet përvojë pune në institucionet e sigurisë publike ose kombëtare, si dhe të mos jetë

larguar/liruar/përfunduar nga detyra për shkaqe disiplinore në 3 vitet e fundit nga koha e aplikimit.”

2. Pika 2 shfuqizohet.

3. Pika 4 ndryshon si vijon:

“4. Procedurat për miratimin e programeve, certifikimin e trajnerit për Qendrën e Trajnimit të punonjësve të SHPSF-së, si dhe përgjegjësitë e tij, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.”

Neni 27 përcakton se:

Pika 2 e nenit 32 ndryshon si më poshtë vijon:

“2. Të dhënat e siguruar nga përdorimi i këtyre pajisjeve trajtohen sipas kërkesave të legjislacionit për masat shtesë të sigurisë publike dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.”

Neni 28 përcakton se:

Pika 1 e nenit 34 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Në veprimtarinë e sigurisë fizike të drejtën e mbajtjes së armëve të zjarrit dhe municionit e kanë drejtuesi teknik dhe punonjësit e shërbimit të pajisur me autorizim përkatës nga Policia e Shtetit, sipas kërkesave të ligjit nr. 74/2014 “Për Armët” i ndryshuar.

a) Autorizimi për mbajtje arme në shërbim, nënkupton të drejtën e drejtuesit teknik dhe punonjësit të shërbimit për mbajtjen e armës gjatë kohës së punës, vetëm në ambientet e punës apo të shërbimit.

b) Autorizimi për mbajtje arme në lëvizje nënkupton të drejtën e punonjësit të shërbimit, truporë, për mbajtjen e armës vetëm gjatë kryerjes së detyrës, edhe jashtë qendrës së banimit apo të punës/shërbimit”.

Neni 29 përcakton se:

Në neni 37 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 37

Pajisjet e shërbimit

1. Subjekti i SHPSF -së për realizimin e shërbimit, vë në dispozicion të punonjësve të shërbimit mjete e pajisje shërbimi të pajisura me autorizim nga Drejtoria Vendore e Policisë. Për realizimin e shërbimit të transportit të vlerave monetare, sendeve të çmuara dhe shërbimit të ruajtjes së afërt të personave fizikë/juridikë (truporë), subjektet përdorin automjete të blinduara sipas standardeve evropiane të pajisura me autorizim me afat 5 vjeçar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Ndalohet dhënia me qera dhe nënkontraktimi i mjeteve të blinduara për personat fizikë e juridikë.

2. Lloji i mjeteve, pajisjeve, automjeteve të shërbimit, automjeteve të blinduara, si dhe mënyra e lëshimit të autorizimit për automjetet e blinduara, përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë”.

Neni 30 përcakton se:

Në nenin 38, pika 4 shfuqizohet.

Neni 31 përcakton se:

Në neni 39 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijojnë:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë vijon:

“a) Për subjektin e licencuar të SHPSF dhe QTP-së :

i) “vërejtje”

ii) “vërejtje me paralajmërim për heqje licence”

iii) “gjobë”

iiii) “heqje e licencës”

2. Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë vijon:

“b) Për titullarin e subjektit dhe drejtuesin teknik të SHPSF dhe QTP”

i) “vërejtje”

ii) “vërejtje me paralajmërim për heqje certifikate”

iii) “heqje e certifikatës”

3. Shkronja “c”, ndryshohet si më poshtë vijon::

“c) Për punonjësën e shërbimit dhe përgjegjësin e shërbimit të SHPSF”

i) “vërejtje”

ii) “vërejtje me paralajmërim për heqje certifikate”

iii) “heqje e certifikatës”

4. Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) Ndarja dhe klasifikimi i shkeljeve sipas llojit të masave disiplinore parashikohet në Udhëzim të Ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 32 përcakton se:

Në nenin 40 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijojnë:

1. Në paragrafin e parë, pas fjalës “SHPSF” shtohet fjala “QTP”

2. Shkronja “ç”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“ç) Kur është dënuar administrativisht me masën “gjobë” ose “vërejtje me paralajmërim për heqje licence” për të njëjtën shkelje më shumë se 2 herë brenda vitit kalendarik.

3. Pas shkronjës “gj” shtohen shkronjat “h”, dhe “i” me këtë përmbajtje:

“h) Kur afati i vlefshmërisë së certifikatës së titullarit ka përfunduar dhe ai nuk ka aplikuar brenda afateve ligjore për certifikim, konsiderohet se aktiviteti ushtrohet për titullar subjekti të certifikuar dhe subjektit i hiqet licenca.

“i) Kur afati i vlefshmërisë së certifikatës së drejtuesit teknik ka përfunduar dhe ai nuk ka aplikuar brenda afateve ligjore për certifikim, konsiderohet se aktiviteti ushtrohet pa drejtues teknik të certifikuar dhe subjektit i hiqet licenca”.

4. Shkronja “f” shfuqizohet.

5. Pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Masa administrative me gjobë e vendosur sipas shkronjës ç, të pikës 1, të këtij neni, nuk aplikohet për shkeljet e punonjësve të shërbimit dhe përgjegjësit të shërbimit.

Neni 33 përcakton se:

Në nenin 41, shkronja “ç”, në pikën 1 ndryshohet si vijon:

“ç) Kur është dënuar administrativisht me masën “gjobë” apo me masën “vërejtje me paralajmërim për heqje licence”, për të njëjtën shkelje më shumë se 2 herë brenda vitit kalendarik.

Neni 34 përcakton se:

Në nenin 42 shkronja “c” dhe “d” ndryshohen si vijon:

“ c) Me propozim të arsyetuar të drejtuesit teknik të subjektit.

“d) Kur është dënuar administrativisht me masën “Vërejtje” apo me masën “Vërejtje me paralajmërim për heqje certifikate për të njëjtën shkelje më shumë se 2 herë brenda vitit kalendarik.

Neni 35 përcakton se:

Në nenin 44 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijnë:

1. Pika 1 ndryshon si vijon:

“1.Për shkeljet e konstatuara për moszbatim të kërkesave të nenit 24 shkronja “b”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “g”, “k”, “m”, “n”, “o”, “p”, “q”, “r”, “rr”, nenit 24/1 shkronja “c”, “e”, “f”, “h”, “i”, “j”, dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri 100 000 (njëqind mijë) lekë”.

2. Në pikën 2, pas termit “neneve”, shtohet togfjalëshi “24/1 shkronja “h”.

3. Pika 3 riformulohet me këtë përmbajtje:

“3) Për shkeljet e konstatuara ndaj drejtuesin teknik të parashikuara nga neni 26, subjekti dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë”.

4. Pas pikës 3 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2 si më poshtë vijnë:

“3/1.Për shkeljet e konstatuara ndaj përgjegjësit të shërbimit të parashikuara nga neni 26/1 subjekti dënohet me masën gjobë nga 10 000 (dhjetëmijë) lekë deri në 30 000 (tridhjetëmijë) lekë.”

“3/2. Për shkeljet e konstatuara ndaj punonjësit të shërbimit të parashikuara nga neni 23 pika 1 dhe 2, nenit 27, 33 pika 1 dhe 5, 34 pika 1, subjekti dënohet me masën gjobë nga 5 000 (pesëmijë) deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë”.

Neni 36 përcakton se:

Neni 45, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 45

Masa administrative për drejtuesin teknik

1. Për shkeljet e konstatuara për moszbatim të kërkesave të këtij ligji, sipas neneve, 26, shkronja “b”, “d”, “dh”, “dh/1”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”; 32, pika 2 dhe 33, pika 5, drejtuesi teknik i jepet masë administrative “vërejtje” ose “vërejtje me paralajmërim.”

Neni 37 përcakton se:

Pas nenit 45 shtohet neni 45/1 me këtë përmbajtje:

“45/1. Për shkeljet e konstatuara tek neni 26/1, germet “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h” “k”, përgjegjësi i shërbimit dënohet me masën “Vërejtje” ose “Vërejtje me paralajmërim”.

Neni 38 përcakton se:

Në nenin 46, pika 1 ndryshohet si vijon:

“1. Për shkeljet e konstatuara për moszbatim të kërkesave të neneve 23 pika 1 dhe 2, nenit 27, 33 pika 1 dhe 5, 34 pika 1 të këtij ligji, punonjësi i shërbimit dënohet me masën “Vërejtje” ose “Vërejtje me paralajmërim”.

Neni 39 përcakton se:

Në Neni 47 bëhen ndryshimet si më poshtë vijnë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Dhënia e masave administrative sipas neneve 44, 45 dhe 45/1 të këtij ligji është kompetencë e DVP-së ose Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit mbi bazën e konstatimeve të shkeljeve gjatë inspektimeve të kryera nga ana e tyre.”

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Dhënia e masave administrative sipas neneve 42 dhe 46 është kompetencë e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë.

3. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Dhënia e masave administrative, sipas nenit 39, germa “a”, pika “i” dhe “ii”, germa “b”, pika “i” dhe “ii”; nenit 40 dhe nenit 41 të këtij ligji, është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit”.

Neni 40 përcakton:

Aktet nënligjore

Ngarkohet Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, që brenda 6 muajve të nxjerr aktet nënligjore në zbatim të nenit 4 pika 6; nenit 13, pika 2; neni 16 pika 3; neni 19 , neni 23, pika 3, neni 26 pika 3, neni 29, pika 2; neni 31 pika 4 të këtij ligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen: Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, institucionet e tjera që në bazë të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi kanë detyrime dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetin e shërbimit të sigurisë fizike.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Grupi i Punës i ngritur më urdhër të Ministrit të Brendshëm, me përfaqësues nga Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Projektligji do të marrë konsultimin e grupeve të interesit dhe vlerësimin e institucioneve të tjera.

Ky projektligj është dërguar për mendim tek Ministria e Drejtësisë dhe tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Gjithashtu, u konsultua me përfaqësuesit e Shërbimit Privat të Sigurimit Fizik më datë 12.07.2022.

Pas vlerësimit nga grupi i punës të mendimeve dhe sugjerimeve të dhëna nga përfaqësuesit e SHPSF-ve, u reflektuan ndryshimet në projektligjin e sipërcituar si më poshtë vijon:

- Në nenin 10 të projektligjit, ku është parashikuar ndryshimi i nenit 11 “Kriteret për certifikimin e drejtuesit teknik” në shkronjën “ç” kriteri për vjetërsi pune nga 10 vjet që u parashikua në projektligjin fillestar u ndryshua në 3 vjet;
- Në nenin 10 dhe 11 të projektligjit është hequr kriteri i moshës (*të mos ketë mbushur moshën e daljes në pension*) si dhe kriteri i shtetësisë shqiptare për drejtuesin teknik dhe punonjësin e shërbimit;
- Është shtuar neni 12 në projektligj i cili ndryshon neni 13 të ligjit nr. 75/2014 duke shtuar parashikimin se shtetasit e huaj gëzojnë të drejtën të certifikohen si drejtues teknik dhe punonjës shërbimi të subjektit nëse plotësojnë, përveç kriterëve të veçanta të përcaktuara në këtë ligj, edhe disa kritere shtesë.
- Në nenin 13 të projektligjit, i cili parashikon ndryshimin e nenit 14 “Kritere për licencim”, është shtuar pika 2 me përmbajtje “2. Për nevoja të veçanta pune ose në rastet e ushtrimit të aktivitetit të SHPSF me një numër të konsiderueshëm punonjësish, subjekti mund të punësojë më shumë se një drejtues teknik për secilën nënkategori licence”;
- Në nenin 16 të projektligjit është shtuar parashikimi për ndryshimin e pikës 2, të nenit 18 të ligjit nr. 75/2014 ku parashikohet se “2. Nuk lejohet nënkontraktimi i kësaj veprimtarie nga një subjekt i SHPSF-së tek tjetri” si vijon: *Nënkontraktimi i kësaj veprimtarie lejohet vetëm duke respektuar të njëjtat kushte dhe kritere të pranuar në kontratën bazë të SHPSF-së, pas miratimit paraprak të Policisë së Shtetit.*”
- Në nenin 20 të projektligjit, ku është parashikuar ndryshimi i nenit 24 “Përgjegjësitë e titullarit të subjektit të SHPSF-së”, shkronja “q” është ndryshuar si vijon “q) Njofton menjëherë Policinë e Shtetit për lidhjen e kontratave të reja, si dhe për çdo ndryshim që pëson kontrata e lidhur që ka të bëjë me aftësinë e sigurisë fizike të objekti dhe brenda 30 ditëve, dorëzon kopje të saj në strukturat vendore të Policisë.

Subjekti i SHPSF-së në çdo rast ruan të drejtën për të mos bërë publik çmimin e kontratës, përjashtimisht kur kërkohet për qëllime statistikore nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit”;

- Gjithashtu, në nenin 20 të projektligjit, janë hequr parashikimet “rr)Të përdorë automjetet e shërbimit me logon e SHSF-se vetëm nga punonjës shërbimi të certifikuar”, pasi përjashton punonjësit administrativë të cilët për nevoja pune përdorin automjetin e subjektit dhe “s) Për ushtrimin e aktivitetit të nënkategorisë 1.3.B “Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit”, të përdorë vetëm automjete të blinduara sipas kategorizimit të përcaktuar me udhëzim të ministrit për rendin e sigurinë publike” si sugjerim edhe nga Ministria e Drejtësisë pasi nuk vlerësohen si detyra të titullarit të subjektit por janë kritere të vendosura për ushtrimin e veprimtarisë së subjektit;
- Në nenin 29 të projektligjit, ku parashikohet ndryshimi i nenit 37 “Pajisjet e shërbimit”, afati i autorizimit që lëshon Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për përdorimin e automjeteve të blinduara nga SHPSF-të u ndryshua nga 3vjet në 5 vjet, me qëllim lëhtësimin dhe uljen e tarifës për këtë shërbim.

Ministria e Mbrojtjes, është shprehur dakort dhe pa komente.

Me shkresën nr. 470 prot., datë 22.07.2022, Ministria e Drejtësisë është shprehur dakort me disa sugjerime.

Sqarojmë se renditja e neneve në projektligj ka ndryshuar për shkak se është shtuar neni 12 i cili parashikon ndryshime në nenin 13 të ligjit nr. 78/2014.

Konkretisht, në komentin 1.1, shprehet se: Në nenin 18 të projektligjit, sugjerohet rishikimi i pikës 1, shkronja “a” dhe “b”, lidhur me parashikimin e bërë mbi ngritjen dhe miratimin e strukturës përgjegjëse të menaxhimit të shërbimit të sigurisë në Policinë e Shtetit. Subjektet e licencuara të shërbimi privat të sigurisë fizike nuk mund të krijojnë struktura shtesë në Policinë e Shtetit.

Lidhur me këtë koment sqarojmë se: Nga ana jonë është reflektuar komenti duke saktësuar se struktura e menaxhimit të shërbimit nuk ngrihet në Policinë e Shtetit por pranë subjektit, ndërsa miratimi i kësaj strukture bëhet nga Policia e Shtetit.

Referuar komentit 1.2, ku shprehet se: Në nenin 19 të projektligjit, sugjerohet rishikimi i pikës 3, me qëllim saktësimin e ngjarjeve për të cilat titullari i subjektit duhet të njoftojë Policinë e Shtetit si dhe rishikimi i pikës 3, të nenit 21, me qëllim saktësimin e ngjarjeve për të cilat drejtuesi teknik duhet të njoftojë Policinë e Shtetit.

Gjithashtu, sugjerohet që shkronjat “rr” dhe “s” mbi përdorimin e automjeteve, në nenin 19 të projektligjit, të hiqen nga kjo dispozitë pasi nuk janë detyrë e titullarit të subjektit, por janë kriteret të vendosura për ushtrimin e veprimtarisë nga subjekti.

Lidhur me këtë koment sqarojmë se: ngjarjet të cilat duhet të raportohen nga titullari i subjektit dhe drejtuesi teknik në Policinë e Shtetit, i referohen të gjitha ngjarjeve kriminale që mund të ndodhin në territorin e objektit që ka në ruajtje, që çenojnë sigurinë e objektit dhe rendin e sigurinë publike. Për këtë arsye nuk mund të ketë listë shteruese.

Lidhur me sugjerimin për të hequr parashikimet në shkronjat “rr” dhe “s”, sqarojmë se nga ana jonë është reflektuar ky sugjerim.

Lidhur me komentin 1.3, ku shprehet se: Në nenin 20 të projektligjit sugjerohet që togfjalëshi “90 ditë” të zëvendësohet me “jo më vonë se 90 ditë”, **sqarojmë se** nga ana jonë është reflektuar ky koment.

Referuar komentit 1.4, ku shprehet se: Në nenin 22 të projektligjit sugjerohet të bëhet saktësimi nëse pozicioni i përgjegjësit të shërbimit është i detyrueshëm për funksionimin e shërbimeve private të sigurisë fizike apo plotësimi i këtij pozicioni është tagër e titullarit të subjektit.

Lidhur me këtë koment sqarojmë se: Punonjësi i shërbimit emërohet në atë pozicion nga titullari i subjektit sipas nevojave të punës, ndërsa kriteret, standartet dhe procedurat për përzgjedhjen përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike. Pra, procedura do të standardizohet me udhëzim.

Referuar komentit 1.5, ku shprehet se: Në nenin 27 të projektligjit mbi përdorimin e armëve të zjarrit, sugjerohet rishikimi i tij në raport me nenin 26/1 i cili parashikon se të drejtën për të mbajtur armë e ka edhe përgjegjësi i shërbimit si dhe riformulimi i shkronjës “b” të pikës 1, të nenit 27 duke saktësuar kohën dhe vendin e mbajtjes së armës.

Lidhur me këtë koment sqarojmë se: Përgjegjësi i shërbimit është punonjës shërbimi i caktuar nga titullari në këtë pozicion dhe për mbajtjen me armë trajtohet si punonjës shërbimi. Gjithashtu, saktësimi i kohës dhe vendit të mbajtjes së armës në lëvizje nga truproja nuk mund të përcaktohet pasi subjekti që ka në ruajtje mund të kryejë lëvizje në vende dhe kohë të ndryshme, për shkak të detyrave funksionale.

Referuar komentit 1.6, ku shprehet se: Në nenin 31, pika 2 të projektligjit mbi ndryshimin e shkronjës “ç”, sugjerohet rishikimi pasi është e paqartë nëse masa “Vërejte me

paralajmëri për heqje licence” duhet të jetë dhënë më shumë se dy herë brenda një viti kalendarik për të proceduar me heqjen e licencës. I njëjti sugjerim vlen edhe për nenin 33 të projektligjit mbi ndryshimin e shkronjës “d” të nenit 42 të ligjit, ***sqarojmë se*** nga ana jonë është reflektuar sugjerimi.

Referuar komenteve në Kreun 2 mbi çështjet e zbatimit të unifikuar të teknikës legislative, ***sqarojmë se*** nga ana jonë janë reflektuar të gjitha sugjerimet.

Me shkresën nr. 15368 prot., datë 16.08.2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë parë në këndvështrimin buxhetor është shprehur dakort dhe pa komente. Lidhur me përmbajtjen e projektligjit ka bërë disa sugjerime.

Referuar komentit nr.1, ku shprehet se: Në nenin 3, pika 5 e projektligjit shkurtesa “QKR” të zëvendësohet me shkurtesën “QKB” në përputhje me ligjin nr. 131/2015, ***sqarojmë se*** nga ana jonë u reflektua sugjerimi i dhënë.

Referuar komentit nr.2, ku shprehet se: Në nenin 6, pika 2 të projektligjit sugjerohet që emërtimi i lincencës me kodin I.3.C në këtë projektligj të jetë i njëjtë me termin e licencës me kodin I.3.C të parashikuar në Aneksin I, të VKM-së nr. 538/2009, ***sqarojmë se*** nga ana jonë u reflektua sugjerimi sipas parashikimit të VKM-së nr. 538/2009.

Referuar komentit nr.3, ku shprehet se: Në nenin 12, pika 1, shkronja “a” të projektligjit (neni 13 në projektligjin e dërguar për bashkërendim) sugjerohet që të rishikohet termi “shoqëri tregtare” pasi kjo përfshin të gjitha format juridike të parashikuara në ligjin nr. 9901/2009 dhe ligjin nr. 9723/2007 dhe në këtë mënyrë edhe shoqëritë komandite dhe kolektive mund të pajisen me licencë “QTP të punonjësve të SHPSF”, ***sqarojmë se*** nga ana jonë u reflektua sugjerimi.

Referuar komentit nr.4, ku shprehet se: Në nenin 12, pika 2 (neni 13 në projektligjin e dërguar për bashkërendim) sugjerohet rishikimi i parashikimit se “Kriteret e veçanta për ushtrimin e aktivitetit I.3.A, I.3.B dhe I.3.C, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike” pasi këto kriteret miratohen me akt nënligjor në zbatim të ligjit nr. 10081/2009. Konkretisht VKM-ja nr. 538/2009 parashikon kriteret e posacme të licencimit për kategoritë I.3.A, I.3.B dhe I.3.C, ***sqarojmë se*** nga ana jonë u reflektua sugjerimi duke parashikuar se udhëzimi i ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike do të përcaktojë kriteret e hollësishme dhe standardet për përmbushjen e kriterëve për ushtrimin e aktivitetit I.3.A, I.3.B, I.3.C si dhe për punësimin e më shumë se një drejtuesi teknik.

Referuar komentit nr.5, ku shprehet se: Lidhur me parashikimin se “Ankimi ndaj vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për refuzimin dhe shfuqizimin e certifikimit dhe licencimit pas shqyrtimit të ankimit bëhet në Gjykatën Administrative” në

nenin 13 të projektligjit (*neni 14 në projektligjin e dërguar për bashkërendim*), sqarojnë se termi “licencim”, nënkupton procesin e lëshimit të licencës dhe bazuar Kodin e Procedurës Administrative dhe në nenin 12, dhe pikën 1 të nenit 29 të ligjit nr. 10081/2009, titulli i licencës shfuqizohet, ***sqarojmë se*** nga ana jonë është reflektuar sugjerimi.

Referuar komentit nr.6, ku shprehet se: Në nenin 15 të projektligjit (*neni 16 në projektligjin e dërguar për bashkërendim*) sugjerohet që terminologjia mbi shërbimin e e ruajtjes të afërt të personave fizikë/juridikë të unifikohet përgjatë të gjithë tekstit, ***sqarojmë se*** nga ana jonë u reflektua.

Referuar komentit nr.7, ku shprehet se: Në nenin 19, (*neni 20 në projektligjin e dërguar për bashkërendim*) pika 6, shkronja “o” dhe “p” ku parashikohet detyrimi për të njoftuar Policinë e Shtetit dhe QKB-në mbi mbylljen dhe ndryshimet e bërë në QKB, sugjerohet që të sqarohet se çfarë nënkuptohet me “mbyllje aktiviteti” si dhe të saktësohet se subjekti ka detyrimin ligjor për të njoftuar QKB-në për cdo ndryshim që prek ose jo kriteret e licencimit, ***sqarojmë se*** nga ana jonë u reflektua.

Referuar komentit nr.8, ku shprehet se: Në nenin 31, (*neni 32 në projektligjin e dërguar për bashkërendim*) shkronja “h” ku parashikohet se “Kur afati i vlefshmërisë së certifikatës së titullarit ka përfunduar dhe ai nuk ka aplikuar brenda afateve ligjore për certifikim, licenca humbet vleshmërinë”, sugjerohet që të bëhet si pika “i” e këtij neni pasi ky është një ndryshim i cili prek kriteret e licencimit, ***sqarojmë se*** nga ana jonë u reflektua.

Referuar komentit nr.9, ku shprehet se: Në nenin 38 (*neni 39 në projektligjin e dërguar për bashkërendim*) të projektligjit ku përcaktohet se “Dhënia e masave administrative sipas neneve 44, 45 dhe 45/1 të këtij ligji është kompetencë e DVP-së ose Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit mbi bazën e konstatimeve të shkeljeve gjatë inspektimeve të kryera nga ana e tyre”, sugjerohet që bazuar në nenin 5, të ligjit nr. 10081/2009 të përcaktohet qartësisht institucioni përgjegjës për revokimin e licencës.

Lidhur me këtë koment sqarojmë se: Nenet 44, 45 dhe 45/1 të ndryshuara nuk parashikojnë masën “heqje/revokim licence” por vetëm masën “gjobë” mbi bazën e konstatimeve të shkeljeve gjatë inspektimeve të kryera.

Me shkresën nr. 4943 prot., datë 22.07.2022, Ministria e Arsimit dhe Sportit është shprehur parimisht dakort duke bërë disa sugjerime.

Referuar komentit se në pikën 1 të nenit 11 të projektligjit togfjalëshi “Të ketë përfunduar arsimin e detyrueshëm 8 ose 9 vjeçar” të zëvendësohet me togfjalëshin “Të ketë përfunduar arsimin bazë”, **sqarojmë se** nga ana jonë u reflektua ky sugjerim.

Referuar komentit se në nenin 20 të projektligjit, në pikën 1, shkonja “c”, fjala “mësimdhënie” të zëvendësohet me fjalën “trajnim”, **sqarojmë se** nga ana jonë u reflektua ky sugjerim.

Referuar komentit se në pikën 1 të nenit 25 të projektligjit, të specifikohet lloji i institucionit arsimor i cili certifikon trajnerët, **sqarojmë se,** nga ana jonë u reflektua sugjerimi duke specifikuar se është Akademia e Sigurisë e cila certifikon trajnerët.

Referuar komentit se në pikën 1 të nenit 25 të projektligjit, duhet të specifikohet nëse programi i trajnimit do të ofrohet si program trajnimi i vazhduar apo program trajnimi profesional, **sqarojmë se,** bazuar në pikën 3, të nenit 25 të projektligjit, (neni 26 në projektligjin e dërguar për bashkërendim) i cili ndryshon pikën 4, të nenit 29 të ligjit, procedura për miratimin e programeve, certifikimin e trajnerit për Qendrën e Trajnimit të punonjësve të SHPSF-së, si dhe përgjegjësitë e tij, do të përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike. Nëpërmjet këtij akti nënligjor do të specifikohet edhe lloji i programit të trajnimit për trajnerët.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk paraqet efekte financiare shtesë për Buxhetin e Shtetit.

PROPOZUES

MINISTRI I BRENDSHËM

BLENDAR ÇUÇI